

GOLBEX WG

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



RREZIK

Para perdorimit, lexoni me kujdes udhëzimet në etikete. _

GOLBEX WG është fungicid i fuqishëm sistemik me veprim preventiv dhe kurativ. Perdoret me efektivitet të lartë në kontrollin e fitoftores në molle, agrume, luleshtrydhe, druret pyjore ornamentale, etj., vrugut në kungullore, vreshta, perime, në sallate të angjinare dhe ka efekt baktericid ndaj zjarrit bakterial (*Erwinia* spp.) dhe *Pseudomonas* spp. Fungicid/baktericid sistemik, për kontrollin e kërpudhave të fam. *Peronosporaceae*, fitoftorës dhe bakteriozave, në kultura të shumta bujqësore dhe pyjore. Thithet nga gjethet dhe rrënjët, dhe depërton menjëherë në indet vegjetative, duke lëvizur në gjithë bimën në drejtim akropetal dhe bazipetal. Pengon mbirjen e sporeve, zhvillimin e micelit dhe sporifikimin. Mekanizmi i veprimit është tërësisht i ndryshëm me fungicidet e tjera, mes tjerash, nuk krijon probleme të lidhura me formimin e çepëve rezistente. Është i përshtatshëm për t'u përdorur në Programet e Kontrollit të Integruar (IPM).

Lenda vepruese: Fosetyl Al 80% (800 g/kg);
Formulimi: Granula të tretshme në ujë
(WG).

GRUPI	P07	FUNGICID
-------	-----	----------

DEKLARATAT E RREZIKUT:

H318 - Shkakton dëmtime serioze të syve

H412 - E dëmshme për organizmat ujorë me efekte afatgjata

EUH208: Përmban 2,4,7,9-tetrametil-5-decin-4,7-diol. Mund të shkaktojë një reaksion alergjik

DEKLARATAT PARAPRAKE:

P261 - Shmangni frymëmarrjen e pluhurit/tymit/gazit/mjegullës/avujve/spërkatjes.

P280 - Vishni doreza mbrojtëse, veshje, syze dhe maskë.

P305+P351+P338 – në rast kontakti me sytë: Shpëlajeni me kujdes me ujë për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit kur ato janë të pranishme dhe mund të bëhet lehtësisht. Vazhdoni me larjen.

P273 - Shmangni lëshimin në mjedis.

P501 - Hidhni përmbajtjen dhe/ose kontejnerin në përputhje me rregulloret mbi mbetjet e rrezikshme.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN

Lëvizni personin jashtë zonës së kontaminuar. Hiqni menjëherë veshjet e kontaminuara.

Në kontakt me sytë, lani me ujë të bollshëm për të paktën 15 minuta. Mos harroni të hiqni lentet e kontaktit.

Në kontakt me lëkurën, lani me shumë ujë dhe sapun, pa fërkim.

Nëse gjëlltitet, mos shkaktoni të vjella dhe mos i jepni asgjë nga goja. Mbajeni pacientin në qetësi. Mbani temperaturën e trupit. Kontrolloni frymëmarrjen tuaj. Nëse është e nevojshme, kryeni frymëmarrje artificiale. Nëse personi është pa ndjenja, shtrijeni në anën e tij me kokën më të ulët se pjesa tjetër e trupit dhe gjunjët gjysmë të përkulur. Nëse është e nevojshme, transferojeni personin e helmuar në një qendër shëndetësore dhe merrni etiketën ose kontejnerin. Mos e lini vetëm në asnjë rast të demtuarin.

Manifestimet klinike që mund të shfaqen në rast ekspozimi dhe/ose kontakti janë:

Nga acarimi në gjërryerje të syve, lëkurës, mukozave, traktit respirator dhe gastrointestinal.

Këshilla terapeutike për mjekët dhe personelin e kujdesit shëndetësor: Në rast të gjëlltitjes, merrni parasysh kryerjen e një endoskopie. Kundërlindikimi: Shurup i Ipecac dhe Neutralizimi. Trajtimi simptomatik.

PERDORIMI

Trangull, pjepër, shalqi: kundër *Pseudoperonospora cubensis*, antraknozës, njollosjes kafe, bakteriozës, me 250-300 gr/dynym.

Në domate në sera dhe fushë: kundër vrugut, alternaries dhe bakteriozave si *Pseudomonas* spp., *Xanthomonas* *vessicatoria*, *Corynebacterium michiganense*, me 250-300 gr/dynym.

Në vresht: kundër vrugut, kalbëzimit gri dhe bakteriozave. Trajtimet fillojnë kur lastari arrin 10 cm, me 2.5 kg/ha ose 200- 250 gr/100 lit ujë, duke përdorur deri në 1000 lit solución/ha në vreshtat në prodhim të plotë dhe vegjetacionin maksimal. Në infeksione të rënda rekomandohet kombinimi me një fungicid kontakti dhe një endoterapeutik. Aplikohen deri 4 trajtime/sezon.

Në agrume: kundër kalbëzimit të frutave (*Phytophthora* sp.), kalbezimit të qafave nga *Pythium* sp. dhe *Phytophthora cactorum*, antraknozës, malsekos, me 5-6 kg/ha ose 250 gr/100 lit ujë. Doza mesatare e solucionit spërkatës është 2000 lit/ha, në vartësi të moshës dhe masës vegjetative. Aplikohen deri 4 trajtime/sezon.

Peme frutore (molle, dardhe, pjeshke, aktinidie (kiwi)): Per kontrollin e vrugut (*Phytophthora cactorum*), spërkatet gjatë vegjetacionit, duke bere nga një spërkatje cdo muaj e duke filluar pas lulezimit e deri 40 dite para vjeljes, me 0.25%. Në bimët e dobësuar nga semundja me aparat gjethor të pa afte për të absorbuar fungicidin siç duhet, trajtohet trungu dhe qafa e bimes një herë në muaj, duke filluar pas lulezimit deri 40 dite para vjeljes. Për këtë përgatitet një paste, duke përdorur 5 kg preparat, të tretur në 100 lit ujë dhe duke shpenzuar 1-2 lit/bimë.

VEREJTJE PER PERDORIMIN:

Përdoren volume të mëdha tretësire spërkatëse, për të siguruar lagje të mirë të masës gjethore. Nuk përzihet me plehrat gjethore me përmbajtje azoti, formulimet e bakrit, me përmbajtje vajrash minerale dhe squfur.

FITOTOKSICITETI

Në dozat dhe bimët e rekomanduara nuk shfaq shenja fitotoksiciteti.

NDIKIMI NE EKOSISTEM

Nuk është dëmtues ndaj bletëve. Është dëmtues ndaj peshqve dhe organizmave të tjera ujore. SPe 3: Për të mbrojtur organizmat ujorë, respektoni një brez sigurie pa u trajtuar 5 m me mbulesë bimore ndaj trupave ujorë sipërfaqësorë

KARENCA:

Agrume 14 dite; Perime 3 deri 7 dite; Rrush 28 dite; Pemet frutore 14 dite.

MAGAZINIMI:

Ruhet në vende të thata, të ajrosura, në ambalazhin origjinal, në temperatura –10 deri 40° C

Numri dhe data e regjistrimit: 744; date 23.1.2024.

Sasia neto e PMB-së apo lëndës vepruese, që ndodhet në ambalazhin bazë: deri në 1 kg;

Numri i serisë ose shenja të tjera identifikuese: ;

Data e prodhimit: ;

Data e skadencës së PMB-së, ruajtur sipas kërkesave të përcaktuara në dosje: 3 vjet;

Lloji i ambalazhit bazë: Material 3-shtresor për mbrojtjen nga lagështia, Shishe COEX ose HDPE;

Emri dhe adresa e prodhuesit: 1. RAINBOW AGROSCIENCES EUROPE, S.A.U. **Adresa:** Pol.

Ind. Fondo de Litera, Autovia A-2 Km 441.6, 22520 Fraga, (HUESCA) SPANJË.

2. SHANDONG WEIFANG RAINBOW CHEMICAL CO. LTD, **Adresa:** Binhai Economic

Develoment Area, Weifang, Shandong 262737, KINË.

Emri dhe adresa e aplikantit: RAINBOW AGROSCIENCES EUROPE, S.A.U., **Adresa:** Pol. Ind. Fondo de Litera, Autovía A-2 Km 441.6 22520 Fraga (HUESCA) SPANJË.

Emri dhe adresa e importuesit: AGROGEN shpk. **Adresa:** Gruemire, Malesi e Madhe.

Emri dhe adresa e ambalazhuesit: SHEGAJ-AGR shpk. **Adresa:** Dobrac, Shkoder.